Projektet

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr.22039/2 **Prot.** **Lezhë, më** 10.11 **.2026**

NJOFTIM

"PËR ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI VENDOSJEN, SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE MENAXHIMIN E PENGESAVE TË KUFIZIMIT TË SHPEJTËSISË (KURRIZET ARTIFICIALE) NË TERRITORIN E BASHKISË LEZHË "

Mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe Rregulloren " Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Lezhë" e miratuar me VKB Nr. 393 datë 18.07.2022 ,

Ju njoftojmë për zhvillimin e dëgjesës publike në lidhje me miratimin rregullores "Mbi vendosjen, specifikimet teknike dhe menaxhimin e pengesave të kufizimit të shpejtësisë (kurrizet artificiale) në territorin e Bashkisë Lezhë.

Qëllimi i dëgjesës publike është prezantimi dhe diskutimi i projekt-rregullores "Mbi vendosjen, specifikimet teknike dhe menaxhimin e pengesave të shpejtësisë (kurrizet artificiale) në territorin e Bashkisë Lezhë", si dhe marrja e mendimeve dhe sugjerimeve nga qytetarët dhe grupet e interesit, me synim përmirësimin e përmbajtjes së saj dhe garantimin e sigurisë rrugore, qarkullimit të sigurt dhe menaxhimit të përshtatshëm të pengesave të shpejtësisë në territorin e Bashkisë Lezhë.

Dëgjesa publike do të zhvillohet në datën **15.12.2026 ora 13:00 në sallën e Bibliotekës "At Gjergj Fishta" Lezhë**.

Rekomandimet mund t'i dërgoni deri në datën 15.12.2026, në adresën zyrtare të email info@lezha.gov.al.

KRYETARI
Pjerin NDREU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LEZHË